

## Akti i Themelimit

### "Alpha 10"

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

Sot, më datë 05/09/2024 të nënshkruarit:

- Shoqëria "PHARMA 10" sh.p.k me seli në adresën: Njësia Administrative nr.4, rruga e Dibrës, godina me nr. 1177, Tiranë me numër NIPT M12123018A, përfaqësuar nga Ortaku i vetem Dejvi Jazexhiu lindur në Berat, Shqipëri më 13/12/1994 identifikuar me numër personal J41213073V.
- Z. Dejvi Jazexhiu, atësia Pérparim, lindur në Berat, Shqipëri më 13/12/1994, banues në adresën Rruga Hajdar Hidi, pll.2, hyrja nr.3, Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J41213073V madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
- Znj. Paula Jazexhiu, atësia Vangjel, lindur në Berat, Shqipëri më 28/10/1996, banues në adresën Rruga Hajdar Hidi, pll.2, hyrja nr.3, Tiranë, me kombësi Shqiptare mbajtëse e kartës së identitetit me numër J66028050S, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Me vullnetin e lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare "(Ligi i Shoqerive) kanë vendosur të krijojnë shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar "Alpha 10 " (Shoqëria) duke nënshkruar këtë Akt Themeli.

### Emri dhe forma ligjore

#### Neni 1.

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë "Alpha 10 " ndjekur në menyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(Ligi i Shoqerive).

### Selia dhe kohëzgjatja

#### Neni 2.

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Njësia Administrative nr.4, rruga e Dibrës, godina me nr. 1177, Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një një afat të pacaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

### Objekti i veprimitarisë

#### **Neni 3.**

- 3.1 Shoqëria do të ketë si objekt kryesor veprimitarie:Laborator mjekesor. Shërbime të analizave mikrobiologjike, kimike, hormonale, bakterologjike, molekulare dhe genetike.. Në fushën e shëndetësisë si qendër diagnostikuese mjekësore. Trajnim, servis, mirëmbajtje, profilaksi të të gjitha aparaturave mjekësore, për laboratorë kimikë dhe biologjike. Blerje dhe shitje e paisjeve mjekësore. Blerje shitje kite, reagent, material mjekësore.
- 3.2 Shoqëria mund të bëjë të gjitha operacionet tregtare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të pasurive të paluajtshme, financiare dhe të kredisë pa kufizim shume, të nevojshme apo të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, apo që sidoqoftë kanë ngjashmëri me qëllimin e shoqërisë. Shoqëria mund të marrë kuota apo pjesëmarrje në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm ose te ndryshëm. Të marrë financime nga institute të ndryshme kredie, edhe nga shoqëri të tjera shtetërore apo private, duke dhënë garancitë e nevojshme imobiliare, reale dhe personale.
- 3.3 Shoqëria mund të kryej cdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

### Kapitali themeltar dhe ndarja e tij

#### **Neni 4.**

- 4.1 Ortakët themelues:

- Shoqëria "PHARMA 10" sh.p.k me seli në adresën: Njësia Administrative nr.4, rruga e Dibrës, godina me nr. 1177, Tiranë me numër NIPT M12123018A, përfaqësuar nga Ortaku i Vetem Dejvi Jazexhiu lindur në Berat, Shqipëri më 13/12/1994 identifikuar me numër personal J41213073V, **zotërues i një kuote të barabartë me vlerë nominale 90%, kontribuon në para në vlerën 5850000 (pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.**
- **Z. Dejvi Jazexhiu**, atësia Përparim, lindur në Berat, Shqipëri më 13/12/1994, banues në adresën Rruga Hajdar Hidi, pll.2, hyrja nr.3, Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J41213073V madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, **zotërues i një kuote të barabartë me vlerë nominale 5% kontribuon në para në vlerën 325000 (treqind e njëzetë e pesë mijë) lekë.**
- **Znj. Paula Jazexhiu**, atësia Vangjel, lindur në Berat, Shqipëri më 28/10/1996, banues në adresën Rruga Hajdar Hidi, pll.2, hyrja nr.3, Tiranë, me kombësi Shqiptare mbajtëse e kartës së identitetit me numër J66028050S, **zotëruese i një kuote të barabartë me vlerë nominale 5%, kontribuon në para në vlerën 325000 (treqind e njëzetë e pesë mijë) lekë.**

- 4.2 Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 6500000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) Lekë, i ndarë në 3 kuota, me një vlerë nominale në përpjestim me vlerën e kuotës së zotëruar, plotësisht të nënshkruara dhe të shlyera nga Ortakët themelues.

#### Organet drejtuese dhe Administrimi

##### Neni 5.

- 5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:
- Asambleja e Përgjithshme e ortakëve
  - Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë: Z Dejvi Jazexhiu i cili e merr këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rinovimi.


#### Dispozita Përfundimtare

##### Neni 6.


- 6.1 Cdo cështje tjeter, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqërítë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 6.2 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Akt Themelimi ose për shkak të ligjit, palët do të përpiken ti zgjidhin ato miqësish. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e palëve do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së parë Tiranë. Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortakët e Shoqërise, sot më datë 05/09/2024 në gjuhën shqipe në dy kopje.


#### ORTAKËT THEMELUES

"PHARMA 10" sh.p.k

  
Dejvi Jazexhiu



  
Paula Jazexhiu

  
Paula Jazexhiu